



Këshilli për përzgjedhjen e kandidatëve për *Çmimin stimulues nga lëmi i shkencave të natyrës* i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në bazë të Rregullores për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës, Rregullorja nr. 1034/2, dt.21.12.2017, shpall

## KONKURS

Për ndarjen e *Çmimit stimulues nga lëmi i shkencave të natyrës*, inxhinierisë dhe teknologjisë, mjekësisë dhe shëndetit, si dhe bujqësisë.

Këshilli për përzgjedhjen e kandidatëve, me qëllim të stimulimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve, ka vendosur që në vitin 2024 të ndajë dy çmime me vlerë prej 2,000.00 Euro. Çmimet do t'iu ndahen shkencëtarëve të rinj deri në moshën 36 vjeç, që kanë të arritura të larta gjatë karrierës së tyre së deritanishme. Ndarja e këtyre çmimeve bëhet me qëllim të vlerësimit dhe promovimit të rezultateve shkencore të brezit të ri, që është edhe një ndër objektivat kryesore të planit strategjik të ASHAK-ut dhe programit Kombëtar të Shkencës.

Kriteret e aplikimit

Të drejtë aplikimi kanë shkencëtarët e Kosovës të disiplinave shkencore në kuadër të shkencave të natyrës, inxhinierisë dhe teknologjisë, mjekësisë dhe shëndetit, dhe të bujqësisë të cilët kanë dëshmi për arritje të larta në punën e tyre hulumtuese-shkencore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin në mënyrë elektronike, në formatin PDF, në emailin: [ashak@ashak.org](mailto:ashak@ashak.org), si në vijim:

- CV –në;
- Listën e publikimeve të së paku dy punimeve shkencore si autor i parë, të botuara në revistat që gjenden në platformat kredibile shkencore (Scopus dhe Web of Science);
- Certifikatën e shtetësisë si dëshmi që është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Certifikatën e lindjes si dëshmi që është nën moshën 36 vjeç në ditën e aplikimit.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet e mësipërme (të domosdoshme) do të vlerësohen edhe për:

- Pjesëmarrje me prezantim me gojë në kongrese, konferenca ose simpoziume ndërkombëtare të nivelit evropian ose botëror;
- Udhëheqje ose pjesëmarrje në projektet shkencore;

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë, 20 mars deri më 19 prill 2024;

Aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen jashtë afatit nuk do të shqyrtohen.

